

## Masat e përkohshme

### Informacion praktik

---

#### Çfarë janë masat e përkohshme?

Kur një ankesë i drejtohet Gjykatës, Gjykata mund t'i kërkojë një Shteti të marrë disa masa të përkohshme, ndërkohë që ajo duhet të vendosë rreth shqyrtimit të çështjes. Zakonisht, Gjykata i drejtohet një Shteti për t'u përmbajtur nga kryerja e ndonjë veprimi, si për shembull moskthimi i individit në vendin e tij të origjinës ku mendohet se ai/ajo do të dënohet me vdekje apo do t'i nënshtrohet torturës.

Gjykata miraton marrjen e masave të përkohshme vetëm në kushte të mirëpërcaktuara, kur ka një rrezik se mund të ndodhin shkelje të rënda të Konventës. Një pjesë e madhe e kërkesave për masa të përkohshme janë pavend dhe refuzohen.

#### Si mund të kontaktoni Gjykatën?

Gjykata ka vënë në dispozicion një numër të veçantë faksi për dërgimin e kërkesave për masa të përkohshme: +33 (0)3 88 41 39 00  
+33 (0)3 90 21 43 50

Luteni të vini re se **mospërdorimi i këtij numri mund të rezultojë në atë që kërkesa juaj të mos trajtohet menjëherë**, në veçanti gjatë periudhave të festave. Për këtë arsye, luteni të përdorni numrin e shënuar më lart për gjithë korrespondencën lidhur me masat e përkohshme.

#### Fakset dhe letrat pranohen nga:

- E hëna deri në të premten nga ora 8:00 deri në ora 16:00\*
- Kërkesat e dërguara pas orës 16:00 normalisht nuk do të trajtohen brenda së njëjtës ditë. ([Kalendari i festave zyrtare](#))

Kërkesat duhet të paraqiten në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe të përmbledhur. Megjithatë, rekomandohet që çdo faks që tejkalon dhjetë faqe të dërgohet në disa pjesë në mënyrë që të merret dhe trajtohet në kushtet më të mira të mundshme.

\* Koha vendore (GMT+1)

## Informacioni dhe dokumentet që i duhen bashkëngjitur kërkesës

---

Shënoni me shkronja të theksuara në faqen e parë të dokumentit:

**“Rule 39. Urgent”**

**Personi i kontaktit (emri dhe detajet e kontaktit):...**

Në rastet e dëbimit apo ekstradimit, duhet të shënohet:

**Largimi pritet të ndodhë më (data, ora dhe destinacioni):...**

Dorëzoni një kërkesë të arsyetuar, të qartë dhe të plotë. Kërkesat për masa të përkohshme duhet të dorëzohen në Gjykatë me pëlqimin e ankuesit dhe preferohet të shoqërohen me një formular të ankimit të plotësuar në mënyrën e duhur. Nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi/ja, menjëherë ose brenda disa ditëve duhet të plotësohet dhe dërgohet një prokurë.

Bashkëngjisni nga një kopje të të gjitha vendimeve që lidhen me kërkesën, në veçanti vendimet e gjykatave të brendshme, të organeve administrative apo autoriteteve të tjera vendore.

Bashkëngjisni nga një kopje të dokumenteve të tjera të cilat mendohet se provojnë pretendimet e paraqitura në Gjykatë.

## Ndjekja e kërkesave

---

Pas dorëzimit të kërkesës për masa të përkohshme, ankuesi/ja apo përfaqësuesi i tij/saj duhet të marrin masa për t’u interesuar rreth saj. Në veçanti, Gjykata duhet të informohet menjëherë lidhur me ndryshimet e statusit administrativ të ankuesit apo rrethanave të tjera (për shembull, dhënia e lejes së qëndrimit apo kthimi në vendin e origjinës). Gjithashtu, përfaqësuesi i kërkuarit/kërkuarës duhet të informojë Gjykatën menjëherë, me iniciativën e tij/saj, lidhur me çdo humbje të mundshme të kontaktit me klientin e tij/saj.